



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural
Direktorijati za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj
Tarım ve Kırsal Kalınma Müdürlüğü



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Nr. 10-320-
Dt. 10.10.2019

**THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT E KOMUNËS SË PRIZRENIT**

**PËR PËRFITIM NE KUADER TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT
“ FURNIZIMI ME MAKINA MJELËSE PËR LOPË QUMËSHTORE“**

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është parashtrimi i kërkesës për “Furnizim me makina mjelëse për lopë qumështore” në kuadër të investimeve kapitale 2019.

II. Kriteret e përgjithshme të pranueshme

- Aplikuesi duhet të dorëzojnë kërkesën e plotësuar në formularin për aplikim, me dokumentet e kërkuar.
- Përfituesi duhet të mbarështoj së paku 5 lopë qumështore të regjistruara në Regjistrin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV.
- Nëse nuk ka fermerqë aplikojnë me numrin e lopëve mbi 5, atëherë vijnë në shprehje edhe ata me më pak se 5 lopë(kësaj kategorie nuk i kërkohet Pagesa direkte)
- Përfituesi nuk mund të jetë në marrëdhënie pune në institucionin që e bënë përkrahjen.
- Përfitues mund të jetë vetëm një anëtarët i së njëjtës bashkësi familjare (me një tatim në pronë përfitues mund të jetë vetëm një fermer).
- Përparësi kanë fermerët të cilët i kanë ndjekur trajnimet për këtë veprimtari.
- Fermerët të cilët kanë përfitur në tre vitet paraprake (makina mjelëse) nuk mund të përfitojnë nga ky program.

III. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e një dokumenti të vlefshëm të Republikës së Kosovës (letërnjoftimi, pasaporta, patentë shoferi).
2. Regjistrin e lëshuar nga Praktika Veterinare të kontraktuara nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV.
3. Dëshmi që është përfitues për pagesa direkte për lopë qumështore.
4. Vërtetimi i tatimit në pronë.
5. Vërtetimi i pagesës së taksës për mbeturina.
6. Çertifikata e pjesëmarrjes në trajnime (nëse Posedon)

IV. Aplikacioni dorëzohet ne zarfe te mbyllura, në të cilën shënohen:

- Titulli i projektit
- të dhënat e fermerit (emri e mbiemri, vendbanimi, adresa, nr. i telefonit)

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **14-18.10. 2019**

Dokumentacioni dorëzohet në sportelin nr. 3.

